Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly of Rahovec

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **29.06.2026,** me fillim në orën **10:00.** Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Fatmir Iska**. Kryesuesi konstatoi se, kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 27 anëtarë, të pranishëm kanë qenë 24.

Kryesuesi: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryetar i komunës, nënkryetar, të nderuar anëtarë të kuvendit komunal, drejtorë të drejtorive komunale, sekretari e kuvendit, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, medie dhe ju të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit. Kjo është mbledhja **e gjashtë** e rregullt dhe në bashkëpunim me kryetarin kemi vendosur për këtë rend dite:

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY
RAHOVEC /ORAHOVAC
Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)
Nr./Br./No 01/163 Nr. i faq/Br.str/No.pg 90
Data/Datum/Date 23 /07/ 2026

REND DITE

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i Raportit të punës së kryetarit për 6-mujorin e parë të vitit 2026;**
3. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, P-00001-0, ZK-Celinë;**
4. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-00001-0, ZK-Celinë;**
5. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), 2027-2029;**
6. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit të Planit për Trashëgimi Kulturore, 2026-2029;**
7. **Rishqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës – lokalet afariste te palestra;**
8. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2026;**
9. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-02240-81, ZK-Rahovec;**
10. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendim për shpallje me interes të përgjithshëm publik, P-04911-0, ZK-Rahovec;**
11. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e Rregullores për Procedurat dhe Kriteret e Ndërtimit në Komunën e Rahovecit, me nr. prot. 01 Nr. 135/26, e datës 28.4.2026;**
12. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.136/26 i dt.28.4.2026 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, kompanisë "Base Friends L.L.C, vendimit 01 nr. 242/24 i datës 23.08.2024 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe**

vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, si dhe Raportit Nr. 1468 i datës 10.04.2026, i komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;

13. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, për parcelën P-71510033-00772-10, ZK – Xërxë;**
14. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shfuqizimin vendimit 01 Nr. 129/26 i datës 24.03.2026 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës P-71510057-02240-40, ZK – Rahovec;**
15. **Shqyrtimi i informatës së KKSB-së për 6-mujorin e parë, janar-qershor të vitit 2026;**
16. **Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve.**

Kryesusi: Atëherë, pas leximit të rendit të ditës prej 16 pikave, po e hapim debatin! A e keni pranuar materialin me kohë, nëse dikush ka vërejtje? Nëse jo, kush është për këtë rend dite?... Me 24 vota "për", miratohet rendi i ditës për mbledhjen e sotme.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: A ka dikush diçka rreth procesverbalit, ndonjë vërejtje?... Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është "për"?... Me 24 vota miratohet pika e parë.

2. Shqyrtimi i Raportit të punës së kryetarit për 6-mujorin e parë të vitit 2026:

Afrim Dina: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, drejtorë, anëtarë të kuvendit. Kryetari është në vizitë jashtë vendit dhe më ka autorizuar mua që ta bëj prezantimin e raportit punës 6-mujore të punës së kryetarit. Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës dhe Planin e Punës së Kryetarit, bëhet edhe raporti i punës për 6 muajt parë. Janë kryer shumë aktivitete dhe punë, duke filluar nga kabineti i kryetarit, si dhe drejtorive që janë në komunën tonë. Besoj që materialin e keni para vetes. Në material janë të paraqitura zotime e kryetarit për një komunë të hapur dhe transparente, si dhe gjithnjë me shërbime më bashkëkohore. Komunë që mbështet qytetarët me nevoja të veçanta, i jep përkrahje trashëgimisë dhe të rinjve. Janë të paraqitura edhe prioritetet për vitin 2026 dhe ndër kryesoret janë: përfundimi i sheshit qendror, përfundimi i ballkonit panoramik, plotësim-ndryshimi i rregullores për Statutin e komunës, përfundimi i Qendrës për Kulturë, Rini, Art dhe Inovacion, rritja e subvencionimit për projekte kulturore, artistike dhe sportive, promovimi i turizmit, rritja e përkrahjes për fermerë dhe bujq dhe kështu me radhë. Për çdo lindje në maternitetin e Rahovecit, gjatë këtij viti është rritur subvencionimi nga 500 në 600€. Do të bëhet edhe sigurimi shëndetësor për fëmijët të cilët janë në qerdhe. Synim kryesor është edhe përfundimi i ndërtimit të shkollave, që disa prej tyre janë në proces të ndërtimit. Në raport janë të paraqitura edhe sfidat e punës dhe një ndër sfidat kryesore është mungesa e mjeteve financiare si pasojë e obligimeve që rrjedhin nga procedura përmbarimore dhe nga kontrata kolektive në sektorin e arsimit. Deri më tani janë tërhequr 4.541.987€. Kjo gjendje do të krijon vështirësi në realizimin e projekteve strategjike në përputhje me planifikimin buxhetor që ka qenë në vitin 2025. Të paraqitura i keni edhe raportet e njësive në kuadër të zyrës së kryetarit.

Defrim Kafexhiu: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë asambleistë, anëtarë të kuvendit. A keni probleme në koalicion qeverisës, apo ku është problemi? Kryetari nuk është këtu, por e ka autorizuar një drejtor për prezantim, duke e ditur që nënkryetari është këtu. Kjo nuk është në rregull. Besoj që është mirë që nënkryetari ta shpalosë raportin 6-mujor të kryetarit. Sipas këtij raporti, deri më tani për vitin 2026 janë tërhequr 4.541.000€.

Lirigzon Kastrati: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, drejtorë, kolegë anëtarë të kuvendit. Drejtor, faleminderit për njoftim rreth raportit. Disa nga sfidat e paraqitura nga ekzekutivi janë mungesa e mjeteve financiare, si pasojë e obligimeve që rrjedhin nga procedura përmbarimore dhe kontrata kolektive në sektorin e arsimit. Sipas këtij raporti, pra për vitin 2026 janë tërhequr 4.541.000€. Për menaxhimin e kësaj kontrate kolektive i kam vërejtjet dhe kritikat e mia. Në KPF, por edhe në seancat e vitit të kaluar kam kërkuar vazhdimisht informacione të sakta rreth asaj që edhe sa kanë mbetur deri më tani? Është shqetësuese, sepse deri në muajin mars i kemi pasur 2.124.000 që janë tërhequr. Kur i kam bërë pyetje drejtorit, ka thënë që janë disa obligime të reja, por nuk ka shumë, janë në përfundim edhe 200.000 (sipas këtij procesverbali që e posedoj). Kërkoj nga ekzekutivi që të na njoftojë se si e ka menaxhuar drejtoria e Arsimit kontratën kolektive dhe këto 4.541.000 a janë të gjitha për kontratën kolektive apo janë edhe për shpenzime përmbarimore? Gjithashtu, në KPF e kemi diskutuar që kemi rritje të stafit arsimor për këtë vit ose për vitin tjetër. Përkundër kësaj, zyra e personalit deklaron se janë shpallur 18 konkurse publike, 2 në shërbimin civil dhe 13 në drejtorinë e Arsimit. Do të thotë: 186 kanë qenë vitin e kaluar, plus tani 13 dhe kjo i bie që janë tepër 200/203 mësimdhënës. Cilët janë indikatorët? Drejtori në KPF tha që janë: mungesa e nxënësve, shuarja e klasëve etj, ndërsa këtu po e shoh që janë shpallur 13 konkurse të reja. Te çështja e drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik po e shoh që ka pasur rritje prej 97% të të hyrave nga taksat komunale. Në vitin 2025 kanë qenë 31.857, ndërsa deri më tani në 2026 janë 63.000. Një rritje e lartë kjo! Çfarë veprime ka marrë drejtoria që të arrihet ky inkasim?

Fahrije Lushi: I nderuar kryesues, nënkryetar, kolegë këshilltarë dhe ju të pranishëm. Dua të ndërlidhem me zyrën e kryetarit, ku thotë që subvencionimi i lehonave është bërë 600€. Nëse ka mundësi ta dimë numrin e lindjeve në QKMF në Rahovec brenda kësaj periudhe 6-mujore? Gjithashtu, janë shqetësuese këto 13 konkurse në drejtorinë e Arsimit. Na duhet një informacion prej drejtorit të Arsimit rreth këtyre konkurseve, për cilat lëndë dhe për cilin cikël janë? Te infrastruktura: Është i dëmosdoshëm rregullimi i dëmeve që janë shkaktuar, përkatësisht për dëmet e shkaktuara nga KRU Gjakova. Te rruga "Visar Hoti dhe "Batalioni i tretë", te e para janë dëme nga KRU Gjakova dhe te rrga e dytë janë dëme të shkaktuar nga dëmtimi i asfaltit. Besoj që, drejtoria përkatëse duhet t'i ketë parasysh ndërhyrjen në këtë rrugë.

Qazim Cana: Përshëndetje kryesues, nënkryetar, drejtorë të drejtërive, kolegë asambleistë. Çështja është rreth funksionalizimit të AMF-ve. Ka kohë që nuk janë funksionale shkaku vërshimeve, sidomos në Polluzhë, Brestoc, Opterushë dhe në Fortesë. Në bazë të Ministrisë së Shëndetësisë duhet ta kemi mjekun familjar dhe tani është në trend që edhe çdo pacient ta ketë mjekun familjar. Që pacientët e lokaliteteve të ndryshme mos të maltretohen, do të ishte mirë funksionalizimi i AMF-ve. Në bazë të raportit të vitit 2025, kryetari e ka cekur se në Shëndetësi janë 45 punëtorë tepër, përkundër kësaj, përsëri ka konkurse për mjekë dhe mirë që po pranohen, por përsëri mungon funksionalizimi i AMF-ve.

Yllka Shehu: Faleminderit i nderuar kryesues, nënkryetar, drejtorë, kolegë asambleistë. Po ndërlidhem me pikën që e diskutoi kolegia Fahria, në lidhje me rritjen e përkrahjes për nënat që lindin në maternitetin e Rahovecit. Para 2 ose 3 seancash e kam bërë një pyetje që ende nuk e kam marrë përgjigjen. A ka gjinekolog që punon me orar të rregullt në QKMF? Përndryshe, nëse gjinekologu punon në orar kujdestarie, atëherë i bie që kjo përkrahje të bie poshtë.

Defrim Kafexhiu: Te raporti 6-mujor i kryetarit, te mangësitë janë edhe që mungojnë raportet më të detajuara të drejtorive përkatëse. Te mangësitë e tjera është edhe diçka që nuk kam mundur ta gjej: kontratat e nënshkruara të dhënies së pronave në shfrytëzim brenda kësaj periudhe 6-mujore (ndoshta mund të jem edhe gabim). Te drejtoria e Arsimit, e kam një pyetje specifike: Emërimi i drejtorit të shkollës "Isa Boletini" a është ligjërisht dhe proceduralisht në rregull? I njëjti person (mësimdhënës) i është nënshtruar konkursit për drejtor të shkollës, si kandidat i vetëm dhe nuk i ka arritur pikët e mjaftueshme të testit me shkrim. I njëjti kandidat emërohet me vendim, për afat të përkohshëm si drejtor i shkollës "Isa Boletini". Kjo punë është e rregulluar edhe ligjërisht, që në

mungesë të drejtorit, zëvendësdrejtori e bën punën e drejtorit. Sa është ligjore kjo? Pa dashur ta gjykoj personin, në sy të qytetarëve kjo punë nuk është në rregull. Kandidati nuk ka arritur ta kalojë testin me shkrim. Do të thotë, për shkak të rezultatit, nuk ka pasur të drejtë t'i nënshtrohet intervistës me gojë. I njëjti pas një muaji, me vendim të kryetarit emërtohet drejtor me afat të pacaktuar. Te drejtoria e Urbanizmit: Te lejet ndërtimore, për 6-muaj janë lëshuar vetëm 20 me leje ndërtimore dhe 39 kushte ndërtimore. Besoj që ka shumë ndërtime pa leje në komunë të Rahovecit. Drejtoria duhet të bëjë marketing dhe t'i ftojë qytetarët për t'u pajisur me leje ndërtimore ose me kushte ndërtimore. Që ky numër i lejeve mos të jetë i vogël, qytetarët duhet të jenë të informuar mbi kriteret dhe lehtësirat që i bën komuna. Te drejtoria e Financave, te buxheti për mallra dhe shërbime: këtu buxheti është shpenzuar 59% brenda 6 muajve dhe a është e mjaftueshme pjesa e mbetur deri në fund të vitit? Gjithashtu, a rrezikohet ky buxhet prej përmbaruesit, prej lëndëve të kontratës kolektive dhe a mund të penalizohen shkollat e komunës së Rahovecit, nëse në mallra dhe shërbime ka mungesë të mjeteve?

Fahrije Lushi: E pata shqetësimin e njëjtë që e përmendi kolegia Yllkë. Paraprakisht duhet të dimë nëse ka gjinekolog në QKMF në Rahovec dhe tutje të marrim sqarime rreth kësaj shume që është jashtëzakonisht e fryer. A është funksional reparti?

Enis Durguti: Përshëndetje për të gjithë! Dua të fokusohem në këtë raport, te zyrat që i kanë ka dy rreshta të përshkruara për aktivitetet 6-mujore. Është pak e quditshme, si p.sh: Zyra e auditimit, e prokurimit, zyra komunale për kthim, sektori i turizmit etj... Me të vërtetë kanë kaq pak për të treguar nga puna e 6-muajve? Te pjesa e turizmit është shkruar "takimi me venarë", por jo edhe me cilët venarë dhe çka është diskutuar. Raporti si raport duhet të jetë pak më i detajuar dhe jo vetëm me dy rreshta, sepse më duket pak cinike.

Afrim Dina: Raporti i ka 22 faqe dhe të gjitha drejtoritë i kanë ka 13-14 faqe. Do të bëhej shumë voluminoz nëse do të inkorporoheshin të gjitha gjërat. Të gjitha drejtoritë veç e veç, nga data 1 korrik do t'i publikojnë raportet e tyre. Ne si drejtori e Administratës e kemi raportin 14 faqe. Te pyetje e zonjës Lushi, drejtori më tregoi se ka gjinekolog dhe se deri më tani janë kryer 16 lindje në maternitetin e QKMF-së në Rahovec.

Afrim Limani: Përshëndetje kryesues, nënkryetar, asambleistë. Lirigzoni e bëri një pyetje në lidhje me kontratën kolektive. I nderuar, deri më tani, po flas për vitin 2026, mjetet e tërhequra për kontratën kolektive dhe nga operatorët është 4.541.000€. Nga këtu, 2.771.000€ janë për kontratën kolektive, ndërsa 1.712.000€ janë për operatorë ekonomikë, të cilët i kanë marrë mjetet përmes përmbaruesit. Tani, besoj që ka ardhur fundi i ekzekutimit të kontratës kolektive edhe pse është e pamundshme t'i siguroj këto informata, sepse ka shumë përmbarues e shumë gjykatës. Sa i përket buxhetit, është e vërtetë që e kemi më të rënduar, si rezultat i zvogëlimit të popullsisë dhe zvogëlimit të numrit të nxënësve. Tani, sipas formulës po dalin të jenë rreth 205 mësimdhënës më tepër dhe për këta 205 detyrohemi t'i japim rreth 2 milionë euro. Konkursi hapet, sepse kur kemi nevojë për matematikë dhe nuk ka as zëvendësime dhe as transfere, atëherë detyrohemi të shpallim konkurs. Defrim, është shumë e vërtetë që buxhetin te mallrat dhe shërbimet e kemi shpenzuar 60%. Kjo kategori është rreth 2.6 milionë. Thesari edhe në këtë kategori i ka tërhequr mbi 500.000€. Detyra jonë është që të kursejmë sa më shumë dhe të paktën t'i përfundojmë disa obligime që i kemi më të rëndësishme (lëndë djegëse), sepse pothuajse kanë mbetur më pak se 400.000€.

Altin Zhuniqi: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë drejtorë, asambleistë. Enis, raporti i drejtorisë është 1 faqe e gjysmë ose dy. Përndyshe, është hapur zyra e turizmit te lokalet e stacionit të autobusëve dhe ty dhe të gjithë të tjerët për kontribut. (Vërejtje* probleme teknike me zërim - Ekonomia Online).

Muhamet Morina: Faleminderit, kryesues! Të nderuar anëtarë të kuvendit, kolegë drejtorë. I pata dy pyetje nga asambleistët e LDK-së dhe 1 pyetje nga Vetëvendosja. Të LDK-së e kanë shqetësimin për numrin e konkurseve të hapura edhe pse numri i mësimdhënësve është i madh. Gjendja në arsim është kjo që është dhe aty ku paraqitet nevoja për konkurs duhet ta hapim, sepse e vetmja mundësi është kjo. Në mesin e këtyre konkurseve ka mësimdhënës që janë pensionuar dhe disa mësimdhënëse prej tyre edhe kanë shkuar në pushim të lehonisë.

Reforma e cila na pret është e dhimshme dhe sinqerisht duhet ta realizojmë, sepse ndryshe nuk bën. P.sh.: janë të angazhuar 3-4 mësimdhënës të gjeografisë në një shkollë, ndërsa në të njëjtën shkollë janë 45-50 orë gjeografi. Kjo i bie që jemi duke i pritur planifikimet e shkollës, përmes drejtorëve përkatës dhe në fund mund ta japim përgjigjen e saktë se ku qëndron problemi i numrit të fryrë të mësimdhënësve, nga 186 në 205. Gjithashtu, duhet ta kemi parasysh që formula që llogarit raportin mësimdhënës-nxënës është 21.3 me 1. Ka shumë shkolla që e kanë vetëm një paralele, p.sh.: një klasë e parë me 8 nxënës, por është veç një klasë dhe nuk kemi çfarë të bëjmë në këto raste dhe këtu prishet standardi i formulës, sepse janë 13 nxënës më pak. Gradualisht do të përpiqemi ta amortizojmë këtë numër dhe ta balancojmë gjendjen. Defrim, e di që e kemi shpall një konkurs për drejtor dhe për ushtruesen e detyrës për të cilën po flet, është e vërtetë që kjo është pranuar pas konkursit dhe nuk e di nëse është e ligjshme, duhet të konsultohemi me ligjshmërinë dhe në seancën e radhës do të përpiqem ta jap përgjigjen.

Lirigzon Kastrati: E dimë që gjendje në arsim është shqetësuese dhe në këtë çështje si grup i asambleistëve të LDK-së do të mundohemi të kontribuojmë. Gjatë këtij mandati, prioritete kryesore janë: arsimi, bujqësia, shëndetësia dhe shërbimet publike. E mbështesim çdo reformë në të mirë të qytetarëve dhe mësimdhënësve të komunës së Rahovecit. Te prokurimi, po e shoh që një aktivitet është anuluar. A është projekti i spërkatjes me dron? Nëse po, pse është anuluar? (*probleme me zërim) Apo është ndonjë projekt tjetër? Te Urbanizmi, cilat janë hapat që janë ndërmarrë rreth çështjes së ndërtimit të kolektorit të shtratit të lumit, Hoçë e Vogël – Brestoc? (*probleme me zërim).

Defrim Kafexhiu: Te drejtoria e Urbanizmit: Nga 46 kërkesa janë lëshuar 39 kushte ndërtimore. Është në rregull me kërkesa, ndonëse ka pak. Ka rritje, por në krahasim me numrin e ndërtimeve që ne po i shohim, atëherë rritja është e zbehtë. Po e them edhe njëherë: Drejtoria duhet t'i njoftojë qytetarët me marketing (kampanj vetëdijësuese), rreth kritereve për leje dhe kushte ndërtimore, që qytetarët të pajisen me leje dhe kushte ndërtimore dhe njëkohësisht t'ju shmangen shkeljes së ligjit. Nuk është në rregull që qytetari fillimisht ta zgjedh dënimin nga inspektoriati, sesa të pajiset me kushte ndërtimore, sepse më i leverdishëm po del të jetë dënimi.

Jusuf Dërmala: Përshëndetje për të gjithë! Një pyetje për drejtorin e Arsimit: Realisht, e përmendi që do të jetë e dhimbshme reforma në arsim. A është planifikuar sistematizimi i këtyre arsimtarëve dhe profesorëve? Çka është ndërmarrë në këtë drejtim?

Enis Durguti: Një pyetje për drejtorin e Arsimit: Drejtor, a keni qenë pjesëmarrës në procesin e zgjedhjes së drejtorit të shkollës "Isa Boletini"? Më intereson ta di se si ka shkuar procesi, sepse si drejtor i Arsimit besoj që është dashur t'i dini këto procedura!

Fahrije Lushi: Kërkoj nga drejtori një informim më të qartë për nënat që planifikojnë për herë të parë të lindin në QKMF në Rahovec. A ka gjinekologë gjatë gjitë kohës? Cili është orari i gjenekologut? Për hir të transparencës, subvencionimi është mjaft solid.

Behar Thaqi: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, drejtorë, ju asambleistë. Lirigzon, tenderi i spërkatjes me dron nuk është anuluar. Në bazë të disa ankesave që janë parashtruar gjatë fazës tenderuese, projekti është në fazën e shqyrtimit nga OSHP-ja.

Jusuf Dërmala: Cili është efekti që do ta jep kjo spërkatje me dron? Pse ka qenë i nevojshëm realisht të bëhet ky tender?

Afrim Dina: Gjinekologu është në gjendje gatishmërie për linje të zakonshme, ndërsa për lindje më të komplikuara duhet të drejtohemi në institucione të tjera.

Muhamet Morina: Jusuf Dërmala pyetje se çfarë do të bëhet me mësimdhënësit, të cilët na mbesin si tepricë teknologjike. Ju thash që, në tavolinën time e kam një plan të reformave, i cili vërtetë është i dhimbshëm. I dhimbshëm në kuptimin e asaj që, kur të balancohen orët, 20 orë për 1 mësimdhënës, atëherë do t'na paraqitet një numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve si tepricë. Për t'i sistemuar këta është sfidë në vete dhe më së paku e mundshme është që t'i sistemon komuna. Unë mendoj që këtë gjë do të duhej ta rregullonte Ministria e Arsimit,

duke filluar ta aplikoj qëndrimin ditor të fëmijëve në shkolla. Në momentin kur aplikohet qëndrimi ditor, do të ketë punë edhe për këtë numër tepricë. Plani i reformave nënkupton: shkolla e cila nuk e plotëson kuotën e numrit 100 të nxënësve. Nëse shkolla i ka 99 nxënës, ajo bëhet paralele e ndarë e shkollës amë dhe nuk ka më drejtor në atë shkollë. Për moment, këtë lloj reforme nuk e kemi parë që po aplikohet në asnjë komunë tjetër. Po presim, nëse ministria po fillon me diçka të tillë dhe tutje veprojmë. Kjo reformë do ta rrisë cilësinë e mësimit dhe do ta forcojë konkurrencën brenda orës mësimore. Asambleisti Enis Durguti pyeti nëse kam qenë pjesë e rekrutimit të drejtoreshës. Po, Enis! Kam qenë pjesëmarrës në cilësinë e drejtorit të Arsimit.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, P-00001-0, ZK-Celinë:

Behar Thaqi: Bëhet fjalë për për pronë të paluajtshme të komunës, ZK Celinë me sipërfaqe 4219m^2. Prona në fjalë gjendet përgjatë rrugës Rahovec - Fortesë (Paskidol). Propozohet që kjo pronë të jepet në shfrytëzim për personat fizikë dhe juridikë për një periudhë 10 vjet. Qëllimi: Zhvillimi i veprimtarisë bujqësore. Çmimi fillestar do të përcaktohet në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi.

Kryesuesi: Këtë pikë e kemi diskutuar edhe në KPF. Nëse nuk ka diskutues, e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenime?... Me 16 vota "për" dhe 1 abstenim, miratohet pika e tretë.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-00001-0, ZK-Celinë:

Behar Thaqi: Pika e katërt lidhet me pikën e tretë. Kërkohet formimi i komisionit prej 5 anëtarëve. Prej tyre 2 janë nga ekzekutivi, 2 nga kuvendit dhe 1 nga shoqëria civile.

Sarandë Sallteku: AAK, e propozojmë Florida Bajraktarin!

Lirigzon Kastrati: LDK, e propozojmë zotëriun Nehar Shala!

Defrim Kafexhiu: LVV, për mbarëvajtje sa më të lehtë të kësaj pike, ne nuk kemi propozim. Personalisht e mbështes propozimin e LDK-së.

Kryesuesi: Faleminderit, Defrim! Këto janë sinjale prej qendrës!

Melinda Iska: PDK, e propozojmë Behlul Krasniqin!

Kryesuesi: Faleminderit! I kemi 3 propozime dhe meqenëse vetëm dy duhet të jenë pjesë e këtij komisioni, atëherë duhet të shkojmë me votim. Kush është "për" Florida Bajraktarin?... Kundër?... Abstenim?... Kush është Nehar Shalën?... Kundër?... Abstenim?... Kush është për Behlul Krasniqin?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, Behlul Krasniqi me 13 vota "për" dhe 1 Abstenim, Florida Bajraktari 12 vota "për" dhe 1 abstenim, si dhe Nehar Shala me 10 vota "për". Nga rezultati, në këtë komision nga kuvendi janë: Florida dhe Behluli. Ndërsa nga ekzekutivi po e autorizojmë kryetarin, gjithnjë duke e respektuar kuotën gjinore. Po e vendosim në votim këtë pikë. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 14 vota "për" dhe 1 abstenim, miratohet pika e katërt.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), 2027-2029:

Afrim Limani: I nderuar kryesues, nënkryetar, drejtorë dhe ju anëtarë të kuvendit.. Në mes të muajit maj ka ardhur qarkorja e parë buxhetore, në të cilën përcaktohen limitet dhe tavanet buxhetore për Komunën e Rahovecit. Brenda këtij afati kemi arritur ta përgatisim KAB-in dhe aty janë të shprehura të gjitha informatat që ndërlidhen me qarkoren buxhetore. Sipas kësaj qarkoreje, buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2027 është 21.704.000€. Ky buxhet ndahet në buxhet të administratës me 9.946.000, buxhet i arsimit 6.843.000, buxhet i cili ka një zvogëlim prej 660.000. Buxheti i shëndetësisë është 2.323.000. Pozicioni i pagave 12.919.000 (59.52%), mallra dhe shërbime 2.821.000 (12.91), shpenzime komunali 440.000 (2.03%), subvencione janë 1.000.000 dhe investimet kapitale janë 4.523.000. Në raport me këtë buxhet, besoj që e kemi përgatitur një KAB të mirë. Në total kemi një rritje të buxhetit prej 156.000, por faktikisht në aspektin financiar nuk qëndrojmë mirë. Faktorët që kanë ndikuar që të vimë në këtë pikë janë dy: regjistrimi i popullsisë dhe njëkohësisht zvogëlimi i popullsisë, si dhe zvogëlimi

i numrit të nxënësve. Në raportin e vitit 2026-2027, kemi zvogëlim prej 740 nxënës. Kjo gjendje është kalkuluar në bazë të formulës në përpjesëtim nxënës-mësimdhënës dhe ka reflektuar drejtpërdrejt ulje të buxhetit. Gjithashtu, këtë vit jemi të goditur edhe nga thesari, për zbatimin e kontratës kolektive dhe nga operatorët që kanë dërguar lëndë në thesar. Deri më tani, vetëm në vitin 2026 janë tërhequr 4.5 milionë. Tani, neve na mbetet të kursejmë më shumë, të paktën t'i përfundojmë disa kontrata që konsiderojmë që janë më të ndishme. Nuk e thashë këtë, por për moment janë 205 mësimdhënës më tepër që ne duhet t'i paguajmë dhe kjo është kosto në paga mbi 2 milionë. Gjithashtu, edhe në sektorin e shëndetësisë janë rreth 50 punëtorë tepër. Mendoj që sa më shpejt duhet të ketë ndryshim-plotësim (amandamentim) i ligjit të financave publike dhe përgjegjësive, sepse i njëjti ka shumë mangësi dhe është i vjetër prej vitit 2001/2002 dhe prej asaj kohe kategoria mallra dhe shërbime për kokë nxënësi paguhet 23 euro. Për këtë arsye, buxheti për shkolla është i limituar dhe si komunë detyrohemi për çdo vit që t'i ndajmëjmë 100.000 euro për shkolla. Të nderuar asambleistë, ju falënderoj për vëmendjen dhe njëkohësisht kërkoj nga ju që ta votoni KAB-in.

Lirigzon Kastrati: Te çështja e KAB-it në parim jemi "për", sepse është një dokument i rëndësishëm strategjik. Te hyrja, e keni përmendur qasjen e buxhetimit të ndjeshëm ndaj fëmijëve, duke siguruar që politikat dhe programet komunale të kontribuojnë në mbrojtjen dhe përfshirjen e tyre sociale. Te çështja e investimeve kapitale e kemi një rënie në krahasim me vitin 2026 (4.9 milionë), ndërsa në vitin 2027 janë 4.5 milionë. Subvencionet te zyra e kryetarit janë kategori që ndërvite ka shënuar rritje. Pse subvencionet në kategoritë e tjera nuk kanë shënuar rritje? Shqetësuese është çështja e buxhetit te pagat dhe mëditjet, ku afër 60% e buxhetit shkon për paga dhe mëditje, ndërsa investimet kapitale mbesin të njëjta.

Defrim Kafexhiu: KAB-i përpilohet çdo vit dhe është dokument strategjik që miratohet nga kuvendet komunale. Është mandati i dytë i imi si anëtar i kuvendit dhe KAB-i është "shabllon" i njëjtë secilin vit, përveç mbështetjes së fëmijëve që e keni shtuar, si dhe ndryshimi i shifrave që është i domosdoshëm. Te strategjia zhvillimore komunale e keni përfshirë edhe ligjin për mbrojtjen e fëmijëve, por askund nuk keni ndarë buxhet enkas për fëmijët. Te investimet kapitale: KAB-i bën planifikim për tre vitet e ardhshme, aq e parasheh edhe Ligji i Prokurimit Publik që investimet kapitale që zhvillohen prej komunës, afatin më të gjatë e kanë 3 vjeçar. Ne jemi dëshmitarë që shumë projekte nuk keni arritur t'i përfundoni përbrenda afatit 3-vjeçar sipas ligjit. Korniza Afatmesme Buxhetore ka përfshirë edhe projekte të vitit 2022-2023 edhe pse tani jemi duke e miratuar KAB-in 2026-2029. Kjo edhe prej shumë arsyeve të tjera, në emër të grupit të LVV-së jemi kundër kësaj Kornize Afatmesme Buxhetore, sepse këtu po përfshini strategji zhvillimore, ndërsa ne edhe qytetarët nuk po shohim zhvillim. Përderisa te investimet kapitale nënshkruhen kontratat pa garancion të mjeteve, atëherë janë kontrata që nuk mund të përmbyllen brenda afateve ligjore. Kemi arsye të mjaftueshme që këtë propozim të ekzekutivit ta votojmë kundër.

Fahrije Lushi: Më ka bërë përshtypje në faqen 7, përkujdesja e qytetarëve me nevoja të veçanta, duke siguruar mbështetje dhe mundësi të barabarta për të gjithë. Në cilin aspekt e keni përshkruar kështu? E thanë edhe parafolësit e mi që shumica e gjërave të paraqitura gati se janë të ngjashme me vitin e kaluar. Kemi tituj që gjendjen e paraqesin shumë të mirë, por në anën tjetër kemi pakënaqësi të qytetarëve në secilin aspekt, aq më tepër qytetarët që janë me aftësi të kufizuara. Te e njëjta faqe është edhe mbrojtja e mjedisit përmes menaxhimit të mbeturinave, trajtimit të ujërave të zeza dhe projekteve të gjelbra. Unë jam shumë pro iniciativave të tilla dhe në anën tjetër, secila hyrje në qytet më bën përshtypje jo të mirë. Hyrja nga Malisheva nuk të bën përshtyje fare për nga mirëmbajtja. Gjithashtu, pjesa nga ana e Kramovikut (Gjakovë – Klinë) është përplot mbeturina, por edhe rruga është e degraduar. Me një fjalë, Komunës së Rahovecit i nevojiten më shumë vepra dhe jo vetëm tituj. Janë bërë ndoshta shumë punë të mira, mirëpo ambienti dhe papastërtia janë shqetësimet kryesore të qytetarëve. Në faqe 9 më ka bërë shumë përshtyje parku ekoturistik dhe edukativ. Po e lexoj fjalë për fjalë, sepse është shumë e mirë për komunën e Rahovecit. Krijimi i një parku natyror me shtigje edukative dhe pika informuese mbi florën dhe faunën lokale, me aktivitete për fëmijë, nxënës dhe për të rritur ndërgjegjësimin ekologjik dhe turizmit.

Afrim Limani: Ju falënderoj për pyetjet! Në fillim e thash që ky dokument ka ardhur në mes të muajit maj dhe kemi pasur kohë të mjaftueshme për ta përgatitur. Konsideroj që ky dokument ndoshta është më i miri deri më tani. Pyetjet nga Lirigzoni dhe Defrimi që thanë: "keni shkruar për fëmijë, por nuk keni ndarë buxhet". Ne kemi shkruar dhe për herë të parë kemi ndarë buxhet. E kemi nënshkruar një kontratë në vlerë prej 78.000€ me një operator. Kontrata e nënshkruar ka të bëjë për sigurim shëndetësor të fëmijëve. Lirigzon, në krahasim me vitin 2026 subvencionet janë të njëjta. Subvencionet te zyra e kryetarit: Pjesa e bursave mbulohet nga zyra e kryetarit (mbi 100.000). Rreth 50.000euro ndahen për aktivitete kulturore. Kryetari e ka të drejtën e subvencionimit të kërkesave të ndryshme që paraqiten për mbulimin e shpenzimeve shëndetësore. Pjesa më e madhe e buxhetit (500.000) është e koncentruar në bujqësi. Ju thash në fillim arsyet e zvogëlimit të investimeve kapitale. Pozicioni i pagave duhet të llogaritet strikt, nuk guxojmë as minus e as tepër ta llogarisim. KAB-in e kemi përgatitut në mënyrë shumë të saktë. Fahrije, te personat me aftësi të kufizuara konsideroj që kemi bërë mjaft. Para 3 viteve, e kemi bërë një projekt në infrastrukturë në qytet për personat me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, vitin e kaluar i kemi ndërtuar dy objekte me standarte të larta. Më gjerësisht e kemi drejtorin e Shëndetësisë, si dhe te mbrojtja e ambientit e kemi drejtorin Përparim. Defrim, the që për fëmijë nuk keni ndarë buxhet dhe e vërtetove që kemi ndarë. Andaj, kërkoj nga ti dhe grupi i LVV-së që ta votoni KAB-in.

Jusuf Dërmala: U përmend sigurimi shëndetësor për fëmijët. Çka përfshin kjo kontratë, kur e dimë që fëmijët deri në moshën 15 vjeçare e kanë shërbimin falas në të gjitha spitalet dhe ambulantat tona? Për kë është bërë, për çerdhet, shkollat?

Enis Durguti: U përmend që ka ulje të investimeve kapitale, por në anën tjetër ka ngritje te pjesa e subvencionimit dhe për 2-3 vite ka ngritje 200-300%. Më la përshtypje fakti që kjo gjendje arsyetohet nga drejtori, sepse të gjithë jemi dakord që të subvencionohen ojq-të dhe pjesët emergjente shëndetësore nga kryetari, por këtu edhe keqpërdoret. Mos harroni, çdo komision që bëhet për subvencionim, lista dërgohet te kryetari për aprovim. Do të thotë që komisioni e kryen punën që e ka për obligim, ndërsa përsëri vendos kryetari, mos të them në shumicë e rasteve. Prandaj, ky mjet i subvencionimit është shumë ideal për përfitime politike dhe pikërisht kjo mundohet të arsyetohet. Në rregull jemi, ne edhe e votojmë KAB-in, por vetëm kur ta arsyetojmë rënien e investimeve kapitale dhe e arsyetojmë pozitivisht rritjen e subvencioneve nga vet krytetari, atëherë më duket pak interesante.

Zana Qanta: Përshëndetje për të gjithë! Në këtë kornizë afatmesme buxhetore flitet për përkujdesje sociale dhe mbështetje për qytetarët në nevojë, por nuk e shohim asnjë program konkret për nënat vetëushqyese. A kam këto familje pjesë e prioriteteve të kësaj qeverisjeje. A ka plan që të krijohet një skemë komunale mbështetëse për nënat që rrisin fëmijët e tyre, të vetme dhe pa përkrahje?

Muhamet Morina: Faleminderit, kryesues! Në pyetjen e Jusuf Dërmalës, se çka përfshin sigurimi shëndetësor për fëmijët: Zona e mbulimit ku fëmijët hospitalizohen, ofrohen këto shërbime që mbulohen 100%: dhoma në spital, shpenzimet e mjekut, shpenzimet për shfrytëzimin e sallës së operacionit, kujdesi intensiv, ekzaminimet radiologjike, transporti me autoambulancë dhe medikamentet. Kuota e mbulimit 80% është atëherë kur kemi shpenzime ambulantore ose kur fëmijët nuk shtrohen në spital dhe këtu përfshihen medikamentet në vlerë deri në 500€. Përfitimet në rast aksidenti, largë qoftë vdekje aksidentale, kontrata i ofron 7000€. Gjithashtu edhe për invaliditet të plotë është 7000€. Kontrata me këtë operator është 78.000€ për 400 fëmijë, ndërsa në çerdhe janë 327 fëmijë.

Lirigzon Kastrati: Drejtori tha që subvencionet janë 10.000 më pak dhe se te zyra e kryetarit jepet për shërbime kulturore etj... Këtu e kemi të vecantë subvencionet për shërbime kulturore 120.000, si dhe infrastruktura rrugore 100.000. Një shpjegim rreth këtyre subvencioneve?

Jusuf Dërmala: E përmenda pak më herët se fëmijët deri në moshën 15 vjeçare kanë shërbime falas në të gjitha ambulantat dhe spitalet. Nuk e di pse ka qenë e nevojshme të bëhet kjo kontratë. E kemi ligjin që është aprovuar në qeveri, ligji për sigurime shëndetësore, i cili do të jetë i zbatueshëm. Pse është ngutur komuna jonë ta bejë këtë

kontratë? Vetëm nëse keni dikujt t'ia bëni qejfin, ose t'ia jepni ndonjë tender, apo diçka të tillë. Më vjen shumë keq, sepse kjo kontratë është e panevojshme, gjithashtu besoj që është edhe antiligjore.

Afrim Limani: Enis, e thash në fillim që buxheti është më i vogël dhe ne duhet në një kategori ekonomike të zbresim diçka dhe në këtë rast i kemi zbritur në investime kapitale. Pagat duhet të jenë strikt, ndërsa mallrat dhe shërbimet janë në kufi. Subvencionet janë të njëjta, 1.000.000 dhe prej tyre 50% i takojnë drejtorisë së Bujqësisë. Bursat për studentë i kemi vendosur në kuadër të zyrës së kryetarit 100.000€, sepse në kuadër të drejtorisë së Kulturës e kemi kulturë, arsimin, sportin dhe rininë. Enis, ka vite që jam drejtor, por nuk e di që kryetari vendosë në zyrë për subvencione. Lirigzon, shërbimet e varrimit janë në kuadër të drejtorisë së Shërbimeve Publike. Zana pyeti rreth subvencionimit të nënave vetëushqyese. Të them të drejtën ne ndajmë subvencione në forma të ndryshme, por subvencionit të veçantë nuk kemi. Mirëpo, nëse nënat vetëushqyese e adresojnë një kërkesë, besoj që do të shqyrtohet dhe do të bëhet nga zyra e kryetarit apo nga drejtoria e Shëndetësisë. (*probleme me zërim).

Enis Durguti: Drejtor, e përmende kulturën, rininë dhe sportin. Pse nuk po i ndani linjat buxhetore veç e veç? Nuk mendoj që është fer që të trijat janë bashkë dhe tani ta shohim se kush ka nevojë. Mendoj që është duke iu bërë padrejtësi këtyre tri sektorëve. Disa komuna i kanë ndarë, ndërsa disa i kanë bashkë si ne. Është e mundshme, pse nuk e marrim një iniciativë të tillë?

Atdhe Rama: Faleminderit! Te ne "kultura" është veç, ndërsa "rinia dhe sporti" janë bashkë. Kështu që, kur e kemi bërë thirrjen për subvencionim, e kemi bërë ndaras.

Kryesuesi: Faleminderit! Nëse nuk ka diskutues të tjerë, po e vendosim në votim KAB-in 2027-2029. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenime?... Me 18 vota "për" dhe 4 kundër, miratohet KAB-i. Shkojmë në pauzë dhe kthehemi në orën 14:00.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit të Planit për Trashëgimi Kulturore, 2026-2029:
(*probleme me zërim dhe videoincizim)

7. Rishqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës – lokalet afariste te palestra: (*probleme me incizim dhe zërim)

Kryesuesi: Po e vendosi në votim komisionin e parë të përbëre nga Nora Boshnjaku dhe Altin Zhuniqi nga ekzekutivi, Berat Duraku dhe Flutura Thaqi nga kuvendi dhe Nazmi Bellaqa nga shoqëria civile. Kush është "për" komisionin e parë, për vlerësimin e ofertave të lokaleve të palestrës? A kemi kundër?... Abstenime?... Me 20 vota "për" miratohet vendimi i parë për formimin e komisionit, që gjithnjë lidhet me lokalet për dhënien në ankand në shfrytëzim. Vazhdojmë me formimin e komisionit të dytë që lidhet me pikën 2.4 të vendimit paraprak si vendim I veçantë. Në dakordim me shefat e grupeve, komisioni mbetet i njëjtë: Nora Boshnjaku dhe Altin Zhuniqi nga ekzekutivi, Berat Duraku dhe Flutura Thaqi nga kuvendi dhe Nazmi Bellaqa nga shoqëria civile. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenime?... Me 17 vota "për" miratohet edhe komisioni i dytë.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2026:

Samir Mustafa: Faleminderit, kryesues! Në mbështetje të nenit 12, pika 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Rahovecit, kryetari i komunës propozon vendimin për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e komunës së Rahovecit, në shumën prej 280€ për vitin 2026. Mjetet do të sigurohen nga kodi i subvencioneve dhe transfereve.

Lirigzon Kastrati: Në emër të grupit të asambleistëve të LDK-së e përkrahim këtë propozim.

Defrim Kafexhiu: Vendimit është dashur t'ia bashkëngjitni edhe specifikat e pagesave sikur viteve të tjera. Gjithashtu e mbështesim këtë vendim.

Kryesuesi: Specifikacionet e shërbimit janë të njëjta sikurse vitin e kaluar. E vendosim në votim. Kush është "për"?... Me 21 vota "për" miratohet vendimi për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2026.

9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-02240-81, ZK-Rahovec:

Besmire Bytyqi: Faleminderit, kryesues! Prona gjendet rrugës për Malishevë, në krahun e djathtë afër pompës "Teuta". Në mandatin e kaluar, kuvendi ka marrë vendim që këtë pronë ta jep në shfrytëzim për 50 vjet. Gjithashtu, në mandatin e kaluar është formuar edhe komisioni. Anëtar i komisionit ka qenë edhe drejtori i Ekonomisë, Erhan Morina, si dhe Sejfullah Sejfullahu nga kuvendit dhe meqë nuk janë më në pozitat e tyre, atëherë neve na mbetet që ta ndryshojmë komisionin dhe të vazhdojmë tutje me procesin.

Saranda Sallteku: AAK, e propozojmë Mentor Durgutin.

Enis Durguti: LDK, e propozojmë Lirigzon Kastratin.

Defrim Kafexhiu: LVV, e mbështesim propozimin e LDK-së.

Melinda Oruqi Iska: PDK, e propozojmë Flutura Thaqin.

Kryesuesi: Atëherë, meqenëse i kemi tre propozime dhe dy na duhen prej kuvendit, më duhet t'i vendosi në votim. Kush është "për" Mentorin?... Kundër?... Abstenime?... Kush është "për" Lirigzonin?... Kundër?... Abstenime?... Kush është "për" Fluturën?... Kundër?... Abstenime?... Atëherë, nga ky rezultat, Mentori i ka 12 vota "për", asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Lirigzoni 11 vota "për", asnjë kundër dhe asnjë abstenim, si dhe Flutura Thaqi 11 vota "për", asnjë kundër dhe 1 abstenim. Më duhet që përsëri ta vendosi në votim, sepse Lirigzoni dhe Flutura e kanë rezultatin e barabartë. Kush është për Mentorin?... Kundër?... Abstenime?... Kush është "për" Lirigzonin?... Kundër?... Abstenime?... Kush është "për" Fluturën?... Kundër?... Abstenime?... Atëherë, përsëri kemi rezultat të njëjtë.

Enis Durguti: Ne po tërhiqemi nga votimi.

Kryesuesi: Atëherë, e kemi një propozim. Nga LDK-ja tërhiqet propozimi i Lirigzonit. E kemi Mentorin me 12 vota "për" dhe Fluturën e kemi me 11 vota "për" dhe 1 asbtenim. Kush është "për" këtë vendim?... Kundër?... Abstenime?... Me 12 vota "për" dhe 1 abstenim, miratohet pika e nëntë e rendit të ditës.

10. Shqyrtimi dhe miratimi i vendim për shpallje me interes të përgjithshëm publik, P-04911-0, ZK-Rahovec:

Besmire Bytyqi: Para jush e keni vendimin për shpalljen me interest ë përgjithshëm publik të parcelës 04911-0. Kjo parcelë është në emër të Kenan Milazim Nimani. Bëhet fjalë për inicim të interesit të përgjithshëm publik. Fillimi i procedurës së këmbimit të pronës komunale me atë private. Prona komunale i ka 952m^2, e cila do të këmbehet me parcelën private në fjalë. Këmbimi të bëhet që 245m^2 t'i japim nga parcela e komunës, në mënyrë që ta bëjmë hapjen e një rruge.

Lirigzon Kastrati: Neni 31 I rregullores për dhënie në shfrytëzim-këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, bëhet si në vijim: kërkesa për këmbim të pronës së paluajtshme nga komuna mund të inicohet nga kryetari i komunës dhe i adresohet kuvendit të komunës apo institucionit qendror me dokumentet përkatëse. Në rast se këmbimi bëhet për më shumë se një pronë, kuvendi voton secilin vendim ndaras. Kërkoj nga drejtoria sqarim në lidhje me atë që nëse e kanë bërë vërtetimin e saktë të personit fizik, a është në rregull ligjërisht me kritere dhe prona e personit fizik I plotëson të gjitha dokumentet përkatëse sipas ligjit?

Defrim Kafexhiu: Drejtoreshë, kush do ta shfrytëzojë këtë rrugë? A ka kërkesë të qytetarëve për qasje në rrugë. Në gjeoportal dhe në dokumente është e paqartë se kujt po i lirohet për shfytëzim kjo parcelë për rrugë.

Besmire Bytyqi: E falënderoj Lirigzonin për kontributin e tij. Këtu është hapi fillestar për ta bërë këmbimin e pronës. Fillimisht, parcelën në fjalë e shpallim me interes të përgjithshëm, ndërsa në seancën e radhës ose varësisht nga MAPL se kur na kthejnë përgjigje për ligjshmëri, atëherë vjen te këmbimi dhe i bëjmë të gjitha hapat siç e kërkon ligji. Defrim, në atë zonë ka shumë parcela të qytetarëve të ndryshëm dhe të njëjtit janë të interesuar që ta kenë në rrugë publike që frekuentohet. Kërkesë me shkrim për hapje të rrugës nuk kemi, mirëpo, synimi ynë është që qytetarëve t'ju lehtësojmë qasjen në parcelat e tyre.

Defrim Kafexhiu: Është fakt që dikush do ta shfrytëzojë këtë parcelë për rrugë. Duke marrë parasysh formën e pronës, ai e ka pronën e pashfrytëzuar aktualisht. Për rrugë bën, por duhet të shfrytëzohet dhe meqenëse nuk paska kërkesa, kjo po i bie që më shumë po ia bëni palës një parcelë katrore 2.7 ari apo sa po i bjen!
Besmire Bytyqi: Kërkesë me shkrim nuk ka, por si ekzekutiv jemi të interesuar që qytetarëve t'ju lehtësojmë qasjen në parcelat e tyre.
Kryesuesi: Faleminderit, drejtoreshë! A ka dikush tjetër diçka në lidhje me këtë pike?... Nëse jo, po e vendosi në votim. Kush është "për"?... me 18 vota "për", miratohet pika e dhjetë.
11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e Rregullores për Procedurat dhe Kriteret e Ndërtimit në Komunën e Rahovecit, me nr. prot. 01 Nr. 135/26, e datës 28.4.2026:
Albnor Mullabazi: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë drejtorë, të nderuar anëtarë të kuvendit. Para jush e keni propozim-vendimin për shfuqizimin e rregullores për procedurat për kushtet dhe lejet ndërtimore. Me vendim të ministrisë është kërkuar që të shfuqizohet kjo rregullore, sepse sipas tyre duhet të pritet miratimi i Hartës Zonale dhe pas miratimit të hartës zonale mund të vazhdojmë me rregulloren.
Lirigzon Kastrati: Drejtor, vendimin që ia keni bashkëngjitur thotë kështu: vendim për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për shërbime publike, 26 janar 2018. Nuk është mirë që këto rregullore-vendime të na rikthehen kështu.
Albnor Mullabazi: Propozimi është vendim për shfuqizim. Ai është gabim teknik, këtu e kam dokumentin origjinal.
Defrim Kafexhiu: Me date 4 maj 2026 ka ardhur për rishqyrtim ky vendim dhe në arsyetim janë 6 paragrafe të shkeljeve që i ka evidentuar MAPL-ja. Do të thotë nuk mund të jetë arsyeja kjo çështja e hartës zonale.
Albnor Mullabazi: Arsyetimi në email është gabim teknik, është arsyetimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike.
Defrim Kafexhiu: Atëherë në rregull! Një pyetje tjetër e kam: duke marrë parasysh që kjo rregullore është miratuar në seancën e prillit dhe aktet që i merr komuna e Rahovecit hyjnë në fuqi 15 ditë pas miratimit. A ka ndonjë vendim që e keni marrë si drejtori e Urbanizmit duke u bazuar në këtë rregullore, pa e marrë ende rishqyrtimin prej MAPL-së?
Lirigzon Kastrati: Drejtori ma dhe vendimin për rishqyrtim, por në arsyetim thuhet që: me Ligjin Nr. 04/L74 për planifikimin hapësinor nuk parashihet ndonjë rregullore apo akt tjetër që përcakton shfrytëzimet dhe kushtet ndërtimore. Planifikimi dhe rregullimi i një zone të caktuar në kuadër të territorit të vendit, duke përfshirë mënyrën e shfrytëzimit dhe kushtet e ndërtimit bëhet vetëm me dokumente të planifikimit hapësinor. Andaj çdo vendim tjetër është përjashtues dhe nuk mund të marrë pëlqim. Drejtor, ti je njohësi i fushës, po është mirë të konsultohesh me zyrtarë ligjorë të drejtorisë, sepse në këtë rast kemi hargjuar kohë dhe njëkohësisht ministria na ka kthyer si antiligjore.
Albnor Mullabazi: Kushtet dhe lejet ndërtimore janë lëshuar në bazë të ligjit, rregullorja përdoret vetëm për si normë. Nuk kemi bërë shkelje, sepse lejet i lëshojmë në bazë të Ligjit për Ndërtim. Kemi dashur ta rifreskojmë, sepse harta zonale të gjithë e dini që është vonuar më shumë se 2 vjet. Tani, brenda 2-3 muajve besoj që miratohet harta zonale, e cila përsëri varet prej ministrisë. Lirigzon, ministria bazohet në ligjin e ndërtimit dhe pas miratimit të hartës zonale, ne përsëri vazhdojmë me rregullore për raste të caktuara. Rregullorja e cila po shfuqizohet është bërë si normë e përgjithshme dhe jo për zona të caktuara.
Lirigzon: Drejtor, pasi të miratohet harta zonale, ju si komunë keni të drejtë ta miratoni një rregullore të re?
Albnor Mullabazi: Pas miratimit të hartës zonale, komuna ka të drejtë të bëjë rregullore për zona dhe lagje të caktuara, varësisht prej kërkesave.
Kryesuesi: A kemi diskutues të tjerë?... Nëse jo, po e vendosi në votim pikën e njëmbëdhjetë. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 17 vota "për" miratohet pika e 11-të.

12. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.136/26 i dt.28.4.2026 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, kompanisë "Base Friends L.L.C", vendimit 01 nr. 242/24 i datës 23.08.2024 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, si dhe Raportit Nr. 1468 i datës 10.04.2026, i komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës:

Mirsad Shala: Përshëndetje! Po e shihni që është një vendim për shfuqizim të vendimit që është dhënë shfrytëzim kompanisë "Base Friends L.L.C", në bazë të vendimit paraprak të kuvendit të komunës që ka qenë dikur shumë më herët. Gjithashtu, pika 2 është shfuqizimi i komisionit, që ka qenë në bazë të këtij vendimi e ka bërë raportin për këtë pronë. Në fund është shfuqizimi i raportit të këtij komisioni. Ky vendim ka ardhur si rezultat i një ligjshmërie nga MAPL-ja dhe thotë që nuk ka të drejtë kjo legjislaturë ta votojë një raport që ka qenë prej asambleistëve të legjislaturës së kaluar. Vendimi bazik për dhënien në shfrytëzim për 20 vjet mbetet në fuqi dhe në pikën tjetër duhet të formohet komisioni për zbatimin e procedurave e shprehjes së interesit.

Lirigzon Kastrati: Fillimisht, si asambleistë të LDK-së nuk jemi kundër kërkujt që u jepet pronë në shfrytëzim. Jemi kundër të mos lejohet të shkelet as ligji, as rregullorja si në rastin konkret. Realisht në këtë vendim po kërkohen të shfuqizohen tri vendime të njëpasnjëshme. Në seancën e muajit shkurt, pata deklaruar që nëse si kuvend vazhdojmë me procedurën siç kërkohet nga ana e ekzekutivit, atëherë po bëjmë veprime procedurale antiligjore. Gjithashtu, në seancën e muajit maj pata deklaruar që, nëse prap vazhdojmë duke e ndryshuar raportin e komisionit, përsëri jemi duke bërë shkelje ligjore. Të gjitha arsyetimet që i kam dhënë në seancat paraprake thonë që ky vendim është antiligjor. Është shqetësuese nga ana e ekzekutivit që vërejtjet tona nuk i merr si të mirëqena, vërejtje këto që kontribuojnë në punën e kuvendit dhe të ekzekutivit. Kryetari gjithashtu e ka përgëzuar drejtorin për përgjigjen e tij dhe pajtohet me atë që nuk janë duke bërë shkelje ligjore, kurse ministria e kthen si vendim antiligjor. Nga ana e ekzekutivit kërkoj që kritikat, vërejtjet dhe sugjerimet që i japim të merren si të mirëqena dhe jo si përshtypje tjetër kinse ne jemi kundër. Jemi "për" që të respektohet ligji, rregullorja dhe të gjitha aktet tjera ligjore. Natyrisht që në këtë rast duhet t'i shfuqizojmë të gjitha pika e votuara, përkundër që ne si asambleistë, këto tri pika nuk i kemi votuar.

Kryesuesi: Faleminderit! Unë e kam një konstatim dhe një pyetje: Në një prej seancave paraprake e kam bërë një pyetje se, a jemi në rregull proceduralisht dhe ligjërisht me këtë vendim? Më keni thënë po, e tash po del që jo. Pyetja: Sa është i vlefshëm vendimi i cili është marrë me datë 13.08.2024? Po e bëj pyetjen, sepse nëse shkojmë me këtë vendim, a ka gjasë që të na rikthehet prej MAPL-së si i kundërligjshëm?

Mirsad Shala: Në vendimin që e prezantova më herët, janë vendimi dhe raporti, që MAPL-ja e ka konstatuar që janë joligjore. Ndërsa vendimi i parë që është vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim është vendim me bazë ligjore, deri në momentin që shfuqizohet po nga ky kuvend. Pika tjetër është për formimin e një komisioni të ri që i zbaton procedurat e shprehjes së interesit dhe pastaj vendimi paraprak.

Defrim Kafexhiu: Mu kujtua tash pasi Lirigzoni tha që ju kam thënë, unë gjithashtu po, por edhe ti kryesues, si dhe edhe Cufa. Ekzekutivi ka vazhduar dhe tani duhet t'i shfuqizojmë këto vendime. Vendimi për raportin e komisionit dhe vendimi për formimin e komisionit, nuk ka pasur nevojë të vendoset në votim atëherë. Nëse tani i shfuqizojmë dhe e lëmë aktiv vendimin që e kemi për dhënien në shfrytëzim është non-sens. Në këtë rast, obligohemi t'i shfuqizojmë, por çka bëhet më tutje me këtë pikë të rendit të ditës? Sipas arsyetimit të MAPL-së edhe vendimi i marrë për dhënien në shfrytëzim është joligjor. Mirsad, si do të vijojnë procedurat tutje?

Lirigzon Kastrati: Arsyetimi i MAPL-së konstaton, përveç vendimit të nxjerrë nga ana e kuvendit që është në kundërshtim me ligjin për dhënien në shfrytëzim, raporti i komisionit, i cili nuk është nënshkruar nga anëtarët e komisionit, gjithashtu vendimi numër 242/24 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme i datës 28.8.2024, duke pasur parasysh se zgjedhjet lokale në Republikën e

Kosovës janë mbajtur më 12.10.2025. Pas konstituimit të legjislaturës së re komunale në Komunën e Rahovecit ka pësuar ndryshime përbërja e kuvendit komunal. Komisioni i formuar me vendim të vitit 2024 nuk mund të konsiderohet funksional për vazhdimin e procedurave gjatë vitit 2026, pasi anëtarët e tij nuk kanë mandat aktiv institucional. Vazhdimi i procedurave nga ana e komisionit bie ndesh me parimet e ligjshmërisë. Konsideroj që këtu duhet të ndryshohet komisioni dhe vendimi për dhënien në shfrytëzim nëse e kemi marrë pas shpalljes së zgjedhjeve lokale, nëse e kemi marrë para zgjedhjeve lokale është në rregull.

Mirsad Shala: Raporti i komisionit dhe vet komisioni ka qenë nga legjislatura e kaluar dhe realisht po shfuqizohet vendimi që ia ka dhënë përfituesit potencial dhe e kanë cekur që raporti nuk bën të jetë i protokoluar tani, ndërsa vendimi ka qenë në mandatin e kaluar. Në vendimin e parë është marrë vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim për një afat të caktuar dhe është ligjërisht në rregull. Në kundërshtim me legjislacionin në fuqi sipas ministrisë janë këto që kanë dalur tani dhe kjo i bie që vendimi i kaluar është në rregull. Në pikën tjetër mund të formohet komisioni që i zbaton procedurat e shprehjes së interesit në bazë të atij vendimi paraprak.

Kryesuesi: Faleminderit! A ka dikush tjetër?... Nëse jo, po e vendosi vendimin për shfuqizim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenime?... Me 21 vota "për" miratohet pika e 12-të.

13. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, për parcelën P-71510033-00772-10, ZK – Xërxë:

Besmire Bytyqi: Në këtë pikë po bëhet formimi i komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale. Bëhet fjalë për parcelën që gjendet në zonën kadastrale në Xërxë. Komisioni përbëhet prej pesë anëtarëve, 2 nga ekzekutivi, 2 nga kuvendi dhe 1 nga shoqëria civile.

Kryesuesi: Kjo pikë lidhet me pikën e 12-të. Duhet t'i marrim dy emra nga kuvendit dhe për 2 të tjerë nga ekzekutivi dhe 1 nga sektori joqeveritar e autorizojmë kryetarin.

Saranda Sallteku: AAK, e propozojmë Lendrit Morinën.

Lirigzon Kastrati: LDK, nuk kemi propozim.

Defrim Kafexhiu: E kam një kërkesë për ekzekutivin dhe grupin e asambleistëve të Aleancës. Meqenëse si opozitë në kritikat tona në seancën e prillit kemi pasur të drejtë, nga ju kërkoj që ta mbështetni një anëtar të komisionit prej opozitës, qoftë prej LVV-së, qoftë prej LDK-së.

Zana Qanta: LVV, e propozojmë Defrim Kafexhiun.

Flutura Thaqi: PDK, e propozojmë Behlul Krasniqin.

Kryesuesi: Atëherë, i kemi tre emra. E kemi edhe një propozim nga Defrim Kafexhiu. Nëse dikush dëshiron të tërhiqet nga propozimi, më tregoni (AAK ose PDK)? Nëse jo, atëherë duhet t'i vendosim në votim.

Feriz Thaqi: Po, ne qëndrojmë në propozimin tonë.

Flutura Thaqi: Po, gjithashtu edhe PDK qëndron në propozimin e saj.

Kryesuesi: Atëherë, kërkesa e Defrimit bie dhe duhet t'i vendosim në votim propozimet. Kush është "për" Lendrit Morinën?... A kemi kundër?... Abstenime?... Kush është "për" Defrim Kafexhiun?... Kundër?... Abstenim?... Kush është "për" Behlul Krasniqin?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, tre kandidatët kanë nga 10 vota "për", përveç Behlulit që ka një abstenim. Në këtë rasti duhet të përsëritet votimi.

Defrim Kafexhiu: Po tërhiqem nga propozimi!

Kryesuesi: Atëherë, nga LVV kemi tërheqje nga propozimi. Tani i kemi dy emra nga kuvendi. Kush është "për" këtë pikë të rendit të ditës?... Kundër?... Abstenim? Me 11 vota "për" dhe 1 abstenim miratohet pika e 13-të.

14. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shfuqizimin vendimit 01 Nr. 129/26 i datës 24.03.2026 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës P-71510057-02240-40, ZK – Rahovec;

Mirsad Shala: Para vetes e keni vendimin për shfuqizimin e vendimit Nr. 129/26 i datës 24.03.2026, për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës P-71510057-02240-40, ZK – Rahovec. Ky shfuqizim është si pasojë e një shkrese të MAPL-së, për arsye se, kuvendi i Kosovës e ka miratur Ligjin për Pronën Publike, ku janë paraparë edhe pronat publike që janë nën administrimin e institucioneve qendrore (Ekonomia e Pyjeve). Në bazë të këtij ligji është rregulluar procedura e bartjes dhe këmbimit në mes pronave të shtetit dhe të komunave. Tani duhet të merret një vendim tjetër, por paraprakisht duhet të ketë pëlqim parimor nga institucioni që e ka në menaxhim pronën dhe në fund te këmbimi duhet të merr vendim qeveria, sepse kështu është e paraparë me ligjin për pronat publike.

Defrim Kafexhiu: Pa dashur të hyj në përmbajtje, sepse u bë e tepër dhe vazhdimisht kemi që edhe zyra ligjore në përpilimin e vendimeve me qenë më vigjilente, sepse vetëm sot i kemi 5 vendime për shfuqizim. Kërkesa prej MAPL-së për rishqyrtim ka ardhur më 20 prill 2026 dhe në kërkesë thuhet që brenda afati ligjor (30 ditë) kuvendi i komunës duhet të merrë veprime. Tani jemi më shumë se 2 muaj prej që ka ardhur vendimi. Nuk po them që ata mund ta marrin ndonjë vendim kundër kuvendit të komunës, por ky vendim për shfuqizim është dashur të jetë në seancën e majit.

Lirigzon Kastrati: Në arsyetim nuk qenka ligji i ri që e potencoi Mirsadi, por përmenden dy ligje: Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligji për Dhënien në Shfrytëzim. (*probleme me zërim dhe videoincizim).

Skender Hamza: I nderuar Defrim, sa i përket çështjes së afatit 30 ditor, ne si zyrë kemi qenë në komunikim me MAPL-në, të cilët kanë kërkuar informata shtesë për këtë vendim dhe më pas ata kanë ardhur në këtë konkluzion.

Kryesuesi: A ka diskutues të tjetër?... Nëse jo, po e vendosi në votim pikën e 14-të. Kush është "për"?... Me 15 vota "për" miratohet pika e katërmbëdhjetë.

15. Shqyrtimi i informatës së KKSB-së për 6-mujorin e parë, janar-qershor të vitit 2026:

Skender Hamza: Faleminderit, kryesues! Në cilësinë e koordinatorit të KKSB-së po e prezantoj informatën për 6-mujorin e parë të vitit 2026, ashtu siç është e paraparë me udhëzim administrativ dhe në planin e punës të kuvendit komunal. Informimi është kërkuar 2 herë në vit me kërkesë të zyrtarit për performancë komunale. Komuna e Rahovecit e ka themeluar KKSB-në më datë 26 janar 2026. Duke u bazuar në udhëzimin e lartcekur, komunat janë të obliguara t'i mbajnë së paku 6 takime brenda vitit. Aktualisht deri më tani i kemi mbajtur 2 takime, sepse ka qenë vit zgjedhor dhe jemi minus një mbledhje. Në këto dy mbledhje si prioritet kanë qenë: siguria e përgjithshme në komunën e Rahovecit, siguria në trafik, qetësia publike, mbrojtja e ambientit dhe kontrolli i produkteve ushqimore. Në këto dy mbledhje, kryetari i ka marrë disa konkluzione. Për çdo pyetje jemi këtu.

15. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve:

Hazbije Shala: Faleminderit! I nderuar kryesues, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë. I kam tri çështje: e para, kanali i ujërave atmosferike në fshatin Retij është nisur si projekt, por ka mbetur i papërfunduar dhe gjatë reshjeve atmosferike ka vështirësi të vazhdueshme. Kërkoj nga komuna intervenim urgjent. Çështja e dytë: Shkolla në fshatin Retijë e Ulët është në gjendje shumë të keqe. Toaletet e shkollës nuk kanë fare qasje në rrjetin e kanalizimit dhe kjo situate ndikon drejtpërdrejt në kushtet e higjienës së nxënësve. Kërkoj nga kryetari i Komunës që urgjentisht t'i ndërmerr masat e nevojshme në këtë shkollë dhe të sigurohet kyçja në rrjet të kanalizimit. Çështja e tretë: Ku ka mbetur procesi i ujit të pijshëm për fshatrat Zoqisht dhe Opterushë?

Bujar Mustafa: Përshëndetje për të gjithë! Pas disa kërkesave të parashtruara në lidhje me problemet me nyjet sanitare në institucione publike, më në fund e pashë që është bërë hapja e thirrjes në prokurim për këtë çështje. E ka parë që është shpallë fituesi me kontratë në vlerë 300.000. Ju përgëzoj për këtë hap të rëndësishëm dhe uroj që sa më shpejt të rregullohen këto probleme. E kam një pyetje për projektin me dron: pasi është dërguar në tenderim tri herë është mirë që ky buxhet të shfrytëzohet për subvencioni, sepse jemi në mes të kësaj faze spërkatjes.

Zana Qanta: Dua ta ngris një çështje që ka të bëjë me jetën e përditshme të banorëve të fshatit Pastasel. Bëhet fjalë për rrugën "Rudina", një segment 80m i gjatë, për të cilën kërkesa është paraqitur në tetor 2024. Sipas banorëve, janë kryer të gjitha matjet dhe janë përfunduar procedurat kadastrale, por realizimi i projektit ende ka mbetur pezull. Si përfaqësuese e qytetarëve, kërkoj përgjegjësi institucionale dhe një afat konkret për realizimin e këtij projekti.

Yllka Shehu: Faleminderit, kryesues! Pyetja e parë ka të bëjë me papërgjegjësinë e mirëmbajtjes së varrezave. Qytetarët na kanë treguar rreth mosmirëmbajtjes së varrezave dhe e kanë hetuar kryesisht ditën e Bajramit, ditë kjo kur varrezat vizitohen më së shumti. Pse ndodh kjo neglizhencë? Pyetja e dytë: kërkesë për kthimin në gjendjen e mëparshme të rrugës kryesore të fshatit Gexhë, për shkak të intervenimeve të KRU Gjakovës. Shqetësimi në fjalë është problem edhe për fshatërat përreth.

Enis Durguti: I kam dy pyetje: Qyteti i Rahovecit është ndër qytetet e vetme që nuk ka shëtitore, shëtitore normale. Është munduar të improvizohet një shëtitore, megjithatë ka shumë probleme të mëdha, rrugës për Drenoc tek Shtëpia e Bardhë. Shkaku i gurthyesve shëtitorja është e pashfrytëzueshme dhe shumë e rrezikshme. Në takimet e përditshme me qytetarë, ankesat janë që kjo shëtitore përveç që është e pashfrytëzuar është edhe e rrezikshme. Kushdo që është përgjegjës për atë pjesë, ju ftoj të ndërhyni dhe ta bëni një plan pak më të mirëfillt. Shetitorja të mos bëhet me gurë dhe zallë, por një shëtitore më të pranueshme dhe të sigurohet vendi që gurët e gurthyesit të mos bijnë aty gjatë gjithë kohës. Pyetjen e dytë e kam me një nënpyetje: Pak jam i zhgënjyer me pjesën e parkingut të sheshit. Makinat parkohen te pjesa brenda, gjithashtu edhe unë jam ndër ata që e frekuentoj parkingun. Në atë pjesë duhet të ndalohet parkingu, sepse kemi plasaritje të betonit dhe ajo pjesë e sheshit është duke u keqpërdorur shumë. E di që për moment nuk kemi mjete të vazhdohet puna në atë pjesë të sheshit, por e di që edhe disa pemë është dashur të vazhdohen të mbjellën aty. Nuk ka mbjellje të pemëve. Nuk ka kurrfarë intervenime, përveç një ngjyrosje që ka ndodhur dhe përsëri ka korrozion (për ju që nuk e vizitoni atë pjesë, ju dërgoj fotot). Jemi në fillim të sezonit veror dhe puna e parkingjeve paksa do të jetë problematike. Çka po ndodh me parkingun nëntokësor? Disa herë e kam cekur që për mua është projekt i dështuar, derisa ma konfirmoni të kundërtën. Ka kohë që ky projekt është i gati dhe nuk lëshohet në përdorim. Pse? Nuk është bërë ende pranimi teknik? Me aq sa e di unë, asnjë projekt në komunë të Rahovecit nuk ka pranim teknik, sepse nuk mund të marrësh pranim teknik, po pasur leje për projektin dhe njëkohësisht nuk kemi asnjë leje për projektet e komunës!

Defrim Kafexhiu: E kam një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike, për gjendjen e rrugëve dhe sidomos për rrugën "Dëshmorët e Pashtrikut". Kur po parashikohet të rregullohet, sepse është në gjendje shumë të keqe. Gjithashtu, kur do të bëhet sanimi i rrugëve të tjera të dëmtuara? Një pyetje tjetër për drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit: A do të ketë aktivitete dhe organizime për "Muajin e Mërgatës"?

Lirigzon Kastrati: Për ekzekutivin i kam tri kërkesa: Te çështja e kanalit të ri që po ndërtohet në fshatin Vrajakë, shqetësimet e qytetarëve i kemi parë edhe në reagim publik, por edhe që janë adresuar te ne si anëtarë të kuvendit. Drejtori të na njoftojë nëse paraprakisht ka diskutuar me ata banorë, që të bëhet ky kanal, i cili është duke ju shkaktuar rrezik në pronat e tyre. Për drejtorin e Bujqësisë: A është themeluar komisioni apo grupi i të korrurave për këtë vit? Te drejtori i Shërbimeve Publike: Varrezat në fshatin Hoçë e Vogël nuk po pastrohen. Gjithashtu te çështja e morgut, kompania nuk po e kryen punën dhe nëse përfshihet prej ndonjë zjarri nga bari aty, atëherë dëmet mund të jenë të konsiderueshme dhe i gjithë ai vetëfinancim nga qytetarët mund të shkatërrohet.

Mentor Veliu: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Dua t'i përgjigjem kolegës së LDK-së në për punën e ambientit. Unë po mundohem në baza javore ose mujore që t'i pastrojmë hyrje-daljet, te rrugët magjistrale që e përfshinë Malishevën, Krushën e Madhe dhe Xërxën edhe pse nuk e kemi as më të voglin obligim si Ekoregjion. Është mbledhja e tretë që kryeari nuk po qëllon këtu, dua ta diskutoj çështjen e qendrës. Të gjithë e dimë gjendjen e buxhetit, por të paktën të planifikohet 2027-tën apo 2028-tën që dhe të merr fund ajo sagë e keqe në qendër të qytetit. Gjithashtu, e kemi edhe parcelën për një objekt të ri për pleqtë e komunës sonë.

Bujar Mustafa: Një pyetje shtesë për drejtorin e Shërbimeve Publike: Ku ka mbetur procesi i licencimit të deponive të mbeturinave të ngurta? Gjithashtu, janë disa drita jofunksionale në Celinë, kur do t'i rregulloni?
Enis Durguti: E di që disa herë është hapur si temë. Është një person me nevoja të veçanta që të gjithë po e shohim në qytet. E di që institucionet specifike janë përgjegjëse, por ju si ekzekutiv besoj që mund ta gjeni një zgjidhje.
Albnor Mullabazi: Enis, nëse dikush ia ka pa të mirat e sheshit, je kon ti. Ke qenë në një rrugë pa dalje, rruga ka qenë pa ndriçim, janë shtuar shumë parkingje. Sa i përket vazhdimit të punimeve, shpresoj që shumë shpejt do të vazhdojnë nëse implementohet granti i performancës.
Atdhe Rama: Po, ne e kemi implementuar një agjendë për "Muajin e Mërgimtarëve" dhe shumë shpejt gjatë javës do të publikohet.
Përparim Krasniqi: Fahrije, te rrugët rajonale nuk jemi përgjegjës për pastrim në asnjë pëllëmbë. Mirëpo, falë Ekoregjionit dhe Ekodrinisë po i pastrojmë edhe ato. Hazbije Shala pyeti për çështjen e kanalit të ujërave atmosferikë në Retijë: Paraprakisht, ndoshta është mirë t'i keni informatat më të sakta. E kemi filluar punën aty, por banorët nuk na kanë lejuar që t'i vazhdojmë punimet, sepse nga kryesia ka pasur mendime të ndryshme: njëri me beton, njëri me gurë etj... Përkundër që nuk kemi pasur buxhet, e kemi lutur operatorin që ta përfundojë si projekt, por përshkak pakënaqësive brenda kryesisë së fshatit, jemi detyruar t'i ndërprejmë punimet. Sa i përket shkollës në Retijë dhe kyçja në kanalizim, është kërkesë me vend dhe do ta shqyrtojmë për vitin e ardhshëm. Sa i përket ujit të pijshëm, Komuna e Rahovecit ka participuar me 200.000€ në këtë projekt, mirëpo ende nuk kemi lëvizje nga ana e KRU Gjakovës, përshkak që nuk ka mbështetje financiare nga Qeveria e Kosovës. Bujar Mustafa pyeti për çështjen e licencimit të deponisë: E kemi marrë një vendim në kuvend dhe sipas ligjit për çështje mjedisore komunat që i kanë nën 50.000 banorë, pëlqimin mjedisor e marrin nga komuna dhe jo nga ministria. E kemi formuar komisionin, i cili është duke i bërë analizat në terren dhe jemi duke vazhduar me procedura të tjera. Sa i përket dritave, një pjesë e kemi lansuar në një lagje në Celinë dhe besoj që, përkundër që zyrtarët e keds-it aty e kanë dëmtuar kabllon, lansimin e dritave shumë shpejt do ta vazhdojmë edhe në lagje të tjera. Lirigzon, pyetje për çështjen e kanalit në Vrajakë. Nuk është kanal, por është shtesë gypore, apo kanal gjatë rrugës apo arës. Tema është që një pronar e ka blerë një parcelë goxha të madhe dhe ekziston një pakënaqësi në mes banorëve, e keni parë edhe në media. Nesër kam takim me banorët e Vrajakës dhe shumë shpejt do ta bëjmë një zgjidhje që të kalojnë ato ujëra atmosferikë dhe të vazhdohet me asfaltim. Yllka Shehu pyeti për çështjen e varrezave: Nuk e di sa je e informuar, por është hera e katërt brenda kësaj periudhe 6-mujore është bërë pastrimi i varrezave të qytetit. Ndoshta me datën e ditës së Bajramit nuk ka qëlluar, por me këto mundësi buxhetore që i kemi është hera e katërt. Sa për informatë, në performancë komunale jemi komuna e parë në nivel vendi, për mirëmbajtje të hapësirave publike. Lirigzon, do të interesohem edhe për pjesën që e përmende dhe do të intervenojmë. Sa i përket shtegut të ecjes, edhe pse nuk jam përgjegjës, komuna e Rahovecit qëndron mirë në këtë aspekt. E kemi shtegun e "Majës së Shkodranit" me gurë, një te Gradishi, një tjetër në Krushë të Madhe. Në vitin 2022 i kemi ndërtuar 5 rrugë në fshatin Pastasel, ajo kërkesë që e përmendi Zana ka qenë pasi që i kemi përfunduar ato rrugë. Është rrugë private dhe sivjet nuk e kemi planifikuar, sepse nuk kemi buxhet. Vitin e ardhshëm duhet të planifikojmë buxhet dhe të vazhdojmë tutje. Defrimi pyeti për çështjen e rrugës "Dëshmorët e Pashtrikut": po e presim KRU Gjakovën dhe besoj që nesër na vjen informata që fillojnë punimet për ndërrimin e gypit, sepse pa e trajtuar çështjen e gypeve nuk bëjmë asfaltim. Për të gjitha gropat që i ka bërë KRU Gjakova, është gjithashtu përgjegjëse për sanimin e tyre.
Kryesuesi: E kam një kërkesë për drejtorin e Administratës: në seancën e ardhshme t'i funksionalizojë këto klima. Një pyetje tjetër për drejtorin e Shërbimeve Publike: Rruga "Vëllezërit Haradinaj"?
Përparim Krasniqi: Rrugën "Vëllezërit Haradinaj" si projekt e kemi dërguar në ministri, por nuk kemi marrë përgjigje. Sipas marrëveshjes së memorandumit, janë rreth 2milionë euro obligime nga operatorit që ende nuk i kanë përfunduar. Në momentin që do të kemi një sinjal pozitiv për ndryshim të memorandumit, do t'i mbyllim punimet në këto rrugë.

Defrim Kafexhiu: Kur do të fillojnë punimet **te** rruga 4-korsi, Rahovec-Xërxë dhe cila është arsyeja që janë ndalur punimet aty? Në fund, po të them që je shumë pozitiv dhe kurrë nuk thua jo.

Përparim Krasniqi: Tani po të them jo, nuk punohet, përderisa nuk kemi mbështetje financiare nga qeveria. Rruga në fjalë është rrugë rajonale dhe i takon ministrisë. Në momentin që ata na ofrojnë mjetet, atëherë kompania e fillon punën brenda natës.

Jusuf Dërmala: Si është puna e rrugës "Jahja Danuza"?

Përparim Krasniqi: E njëjta situatë është, si për rrugën "Vëllezërit Haradinaj" e "Xhelal Hajda". Është një kontratë që i ka 15 segmente rrugore, kontratë për të cilën kemi marrëveshje me Ministrinë e Infrastrukturës, por ende nuk kemi mbështetje financiare. Në këtë rast ministria ende është në obligime, sepse ne i kemi përfunduar disa rrugë në mbështetje të këtij memorandumi.

Kryesuesi: Faleminderit! Po, drejtori i Administratës për përgjigje dhe njëkohësisht le të përgjigjet për disa laptopë për kuvendarë.

Afrim Dina: Në fillim të seancës kanë punuar 4 klima, për momentin janë duke funksionuar vetëm dy, sepse për shkaqe elektrike dy prej tyre u bënë jofunksionale. Nga nesër do të rregullohen. Te pjesa e loptopëve: procedurat i kemi hapur qe sa kohë, mirëpo kompanitë që kanë ofertuar nuk i kanë përmbushur kriteret, në bazë të performancave të kërkuara në tenderim. Ky tender do të shpallet përsëri.

Kryesuesi: Faleminderit shumë! Po e mbyllim seancën e gjashtë, shihemi në seancën e radhës në korrik.

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

K R Y E S U E S I

Fatmir Iska